



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 06.02.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i Rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.01.2012;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2012;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.01.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.01.2012 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2012

Kryetari i Komisionit- Plani i punës është shqyrtuar në një mbledhje të kaluar por i janë bërë disa plotësime nga DCAF (Democratic Control of Armed Forces) në draftin e fundit për aktivitetet e Komisionit.

Këto ndryshime janë:

1. Takim me DCAF-in, dakordim për bashkëpunim mes dy palëve për aktivitete të përbashkëta.
2. Tryezë e rrumbullakët për koordinimin e sektorit të sigurisë për anëtarët e përzgjedhur të komisioneve, përfaqësuesve të Qeverisë me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit mes institucioneve. Kjo është paraparë në muajin mars, datat e sakta do të caktohen në mbledhjen e ardhshme në mënyrë që të ketë koordinim nga të gjitha palët.
3. Vizitë studimore, tematike do të përcaktohet në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit me qëllim të ndarjes së përvojave me vendet perëndimore. Kjo parashihet në muajin prill-maj.
4. Seminar një ditor për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë dhe të drejtave të Njeriut dhe barazisë gjinore për anëtarët e zgjedhur të komisioneve dhe përfaqësuesit e sektorit të sigurisë së Kosovës, me qëllim të ndarjes së përvojave dhe ngritjes së bashkëpunimit mes institucioneve.
5. Trajnim një ditor për srafin e Komisionit për mbikëqyrjen e Agjensisë së Kosovës për Integritet dhe të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, ngritja e kapaciteteve. Kjo parashihet për muajin qershor.

Për hollësi ia jap fjalën zyrtare të projektit të DCAF, Luanda Domi.

Zyrtare e Projektit të DCAF, Luanda Domi- Do ta veçoja vizitën studimore, me Kryetarin e Komisionit dhe disa nga anëtarët e Komisionit jemi konsultuar për temat më të përshtatshme për këtë vizitë studimore dhe deri më tani prioritet ka qenë *Përgjimi i telekomunikimeve*, pasi Komisioni projektligjin për Përgjimin e telekomunikimeve do ta merr me 30 mars 2012, e rëndësishme është caktimi i datës së përshtatshme për Komisionin . Kjo vizitë parashihet nga 15-20 prill 2012, për ti parë modelet e huaja në përgjimin e telekomunikimeve, bashkëpunim me Komisionet e tjera Parlamentare që lidhen me këtë fushë në mënyrë që të ofrojnë mbështetje për një Model që do të hulumtohet.

Kryetari i Komisionit- Ftoi anëtarët e Komisionit për debat për draftin e Planit të Komisionit dhe shtoi se sa i përket Projektligji për komunikimet duke qenë se është i ndjeshëm, ne do të kërkojmë ekspertizën e të tjerëve dhe një përkushtim të madh nga ana e Komisionit dhe përkrahjen e ekspertëve nga vende të tjera.

Rexhep Selimi- Këtë vit gjithsej janë katër Projektligje që do të trajtohen dhe procedohen në Komision, kjo na krijon komoditetin që Komisioni të ketë rol mbikëqyrës më të madh dhe se aktivitetet e Komisionit mund edhe të shtohen qoftë në pjesëmarrje në seminare dhe në veprimtarinë e Komisionit. Duhet të jemi të sigurt që në planin e punës për 2012 të jenë të përfshira të gjitha aktivitetet mbikëqyrëse të Komisionit ndaj atyre Institucioneve që ka kompetencë t'i mbikëqyr.

Planit duhet ti bëhen disa përmirësime të karakterit teknik siç janë emërtimet e sakta. Në planin e punës të përfshihet që në muajin mars të ketë një monitorim të Inspektoratit Policor të Kosovës. Gjithashtu kur i referohet vizitave do të ishte e rrugës që të përshkruhet karakteri

i vizitës apo udhëtimit. Planit mund ti bëhen ndryshime eventuale varësisht nga rrjedha e veprimtarisë së Komisionit.

Fatmir Xhelili- Plani i ka objektivat e qarta por me qëllim të ngritjes së kualitetit të punës së Komisionit, pasi në plani i referohet shume Raporteve. Me qëllim që mos të mbesim në nivelin e leximit të Raporteve të gjejmë një formë të identifikimit të mangësive qoftë në zbatimin e ligjeve apo funksionimin e mekanizmave të sigurisë në mënyrë që mbikëqyrja nga ana e Komisionit të ndikoj në rritjen e kualitetit të punës dhe për këtë çështje mbështetja nga OSCE-ja do të kontribuonte pozitivisht.

Kryetari i Komisionit- Ky plan i punës për 2012 është orientues do të ketë aktivitete të tjera, por ky planë është bazuar edhe në raportin që kemi me komisionet e tjera Parlamentare me Kryesinë e Kuvendit. Për Inspektoratin Policor për monitorimin e implementimit të ligjit do të përfshihet në planin e punës për muajin mars.

Fatmir Xhelili- E rëndësishme është që të specifikohet se për çfarë do të bëhet raporti, të specifikohet roli mbikëqyrës i Komisionit, pasi fjala Raport nënkupton më shume.

Rexhep Selimi- Duke e ditur që funksioni i Komisionit është mbikëqyrës, do të duhej që terminologjia e përdorur në planin e punës të jetë adekuate kur përshkruhen pikat e planit për vitin 2012, këto vërejtje janë të karakterit teknik pasi plani i punës për 2012 do të plotësohet me aktivitete shtesë.

Kryetari i Komisionit- Ky plan është orientues dhe në çdo fillim muaji do të plotësohet me pikat shtesë. Vizitat dhe me specifikat që u theksuan në këtë takim në mënyrë që ta plotësojmë planin e punës.

Tutje konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, miratoi Planin e punës së Komisionit për vitin 2012 me vërejtjet e paraqitura nga anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Sa i përket buxhetit të Komisionit, do të rishikohet në mënyrë që shpenzimi i tij të bëhet në funksion të Komisionit dhe që puna e bërë nga Komisioni të ketë efektin maksimal dhe me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi